



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi “Zog I” , Godina 57/2 Nr.18 Tiranë,

Tel. 04 2268142; Fax 04 2268141

Nr. 928/8 Prot.

Tiranë, më 04.07.2016

V E N D I M

Nr. 76, datë 04.07.2016

“Për verifikimin e zbatimit të vendimit nr.40, datë 01.04.2016 “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me Urdhrin nr.928/1, dt.05.01.2015”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 77-97, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të ardhur nga Bashkia Cërrik me shkresën nr.983/4, dt.14.04.2016, në lidhje me zbatimin e vendimit nr.40, dt.01.04.2016 “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me Urdhrin nr.928/1, dt.05.01.2016”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

Vërej se:

Në zbatim të Urdhrit të Verifikimit nr.928/1, dt.05.01.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me ligjshmërinë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për shkak ristrukturimi, të punonjësës *****, në pozicionin e punës “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”, në Njësinë Administrative Gostimë, Bashkia Cërrik, është kryer hetimi i plotë administrativ.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr.40, datë 01.04.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit filluar me Urdhrin nr.928/1 prot., dt.05.01.2015”, në të cilin është vendosur:

1. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për revokimin e Urdhrit nr.5, dt.25.02.2015, të Kryetarit të Komunës Gostimë, për emërimin në detyrë “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”, të punonjësës *****.

2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për plotësimin e vendimit nr. 3, dt. 21.09.2015, në pikën 1/18, që është marrë nga kjo strukturë, në momentin e ristrukturimit, në pjesën e konfirmimit të statusit të punësimit të punonjësës *****, duke e përcaktuar në këtë akt, si: “*nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin e mëparshëm të punës, “*Inspektore e Tatim-Taksave*”.
3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse, që të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë, për plotësimin e vendimit nr. 6/5, dt.21.10.2015, të njësisë përgjegjëse, për lirimin nga detyra të punonjësës *****, shoqëruar nga akti administrativ i Kryetarit të Bashkisë Cërrik, nr.615/4 prot., dt.21.10.2015, “*Dërgim vendimi*”, duke pasqyruar në këtë akt, në mënyrë të shprehur, statusin e saj të punësimit, në momentin e ristrukturimit të institucionit, si: “*nëpunës civil në periudhë prove*”, në pozicionin e punës, “*Inspektor i Tatim-Taksave*”.
4. Në aktin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, të përcaktohen të gjitha përfitimet prej pikave 7 dhe 8 të nenit 50 të ligjit nr. 152/201, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, që kanë të bëjnë me dhënien e një shpërblimi në përputhje me vjetërsinë në shërbimin civil dhe mundësinë që brenda një periudhe 2-vjeçare, të konkurojë si nëpunëse civile për procedurat e lëvizjes paralele, apo të ngritjes në detyrë, ose të emërohet në mënyrë të përkohshme, me pëlqimin e saj, në pozicione të shërbimit civil, që lirohen përkohësisht, për shkak sëmundjeje, leje lindje e arsye të tjera ligjore, në nivelin ekzekutiv.
5. Bashkia Cërrik, të zbatojë vendimin brenda 15 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin, për zbatimin e vendimit.

Brenda afatit procedural të parashikuar në pikën 5, të Vendimit nr.40, dt.01.04.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Bashkia Cërrik me shkresën nr.983/4, dt.14.04.2016, të Kryetarit të Bashkisë Cërrik ka njoftuar Komisionerin në lidhje me zbatimin e vendimit të mësipërm.

Nga verifikimi i dokumenteve bashkëngjitur kësaj shkrese, rezultoi se:

- ✓ Në zbatim të pikës 1 të Vendimit nr. 40, datë 01.04.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, njësia përgjegjëse me Vendimin nr.983/1, datë 14.04.2016, ka revokuar Urdhrin nr.5, dt.25.02.2015 të Kryetarit të Komunës Gostimë, për emërimin e punonjësës *****, në detyrën “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”.
- ✓ Në zbatim të pikave 2 dhe 3 të vendimit, njësia përgjegjëse me anë të Vendimit nr.983/2, dt. 14.04.2016, ka plotësuar Vendimin nr.3, dt.21.09.2015, duke konfirmuar statusin e punësimit të punonjësës *****, “*nëpunëse civile në periudhë prove*”, në pozicionin “*Inspektore e Tatim-Taksave*” dhe e ka pasqyruar atë në Vendimin nr.6/5, dt.21.10.2015, për lirimin nga detyra të kësaj punonjëseje.

- ✓ Në zbatim të pikës 4 të vendimit, njësia përgjegjëse me anë të Vendimit nr.983/3, dt.14.04.2016, i ka njohur punonjësës ***** të drejtat e parashikuara në pikat 7 dhe 8 të nenit 50 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Sa më sipër, konstatoj se, Vendimi nr.40, datë 01.04.2015 , “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.928/ 1 prot., dt.05.01.2016”, është zbatuar plotësisht, nga ana e subjektit, **Bashkia Cërrik**.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.40, dt.01.04.2016, në institucionin, Bashkia Cërrik.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 40, datë 01.04.2015 ,“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr.928/ 1 prot ., dt.05.01.2016”.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Cërrik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA